



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr.257/2020
Datë: 18 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e 242-të, të mbajtur me datë 18 nëntor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë për të shërbyer në Panelin Hetimor në lëndën Nr.AD/KGJK/32/2020/GJTHFR - AD.nr.2/20, caktohen gjyqtarët:

- Alajdin Tërshnjaku, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kryesues;
- Liljana Stefanović, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, anëtare;
- Arben Musatafaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, anëtar;

- Raima Elezi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, anëtare rezervë;
- Hajrullah Aruqi, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, anëtar rezervë.

II. Vendimi hyn në fuqi me datë 18 nëntor 2020.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2020, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, sipas nenit 11 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve, që janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që do të hetohet.

Paneli Hetimor zhvillon hetimin bazuar në nenin 12 paragrafi 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethanat të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit, Këshilli mundë t'i zgjasë mandatin panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.

Skender QOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Arkivit.